



**VENDIM**

**Nr.46 Datë 28.05. 2009**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.63 DATË 13.06.2008 “PËR  
DHËNIEN E LICENSËS NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT  
INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE  
ELEKTRIK ME ERE DHE PRODHIMIN E ENERGJISE  
ELEKTRIKE ”**

**(PARKU EOLIK KAVAJË)**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma a, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës .05.2009, mbasi shqyrtoi kerkesën e shoqërisë “ERS – 08” sh.p.k për shtyrjen e afateve të përcaktuara në Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 63, datë 13.06.2008 “Për dhënien e licensës në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike” (Parku Eolik Kavajë), dhe konsideroi të drejtë atë,

**Vendosi:**

1. Në vendimin Nr.63, datë 13.06.2008 për dhënien e licensës “Në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga “Parku Eolik Kavajë” të bëhet ky ndryshim:

- në pikën 1, gërma “a” , afati prej 12 muajsh të ndryshohet dhe të bëhet 18 muaj.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë

aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.63, datë 13.06.2008.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari I ERE-s  
Bujar Nepravishta  
Ne mungese dhe me porosi  
Ardian Haci**